



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1163/2 Prot.

Tiranë, më 04.06.2026

VENDIM

Nr. 42 Datë 04.06 2026

“PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT MASTER NË
"STËRVITJE SPORTIVE DHE TË USHQYERIT" MIDIS UNIVERSITETIT TË
SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES DHE
UNIVERSITETIT EUROPIAN TË MADRIDIT”

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, në nenin 7, 43 të Statutit të UST-së, në Rregulloren e UST-së, në Vendimin e Rektoratit nr. 78 dt 11.05.2026, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 75 datë 13.05.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 04.06.2026,

V E N D O S I :

01. Miratimin e marrëveshjes së programit të përbashkët Master në "Stërvitja Sportive dhe të Ushqyerit", midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe Universitetit European të Madridit (bashkëlidhur vendimit).
02. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Administratorit të UST-së
03. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

